



Buletini Informativ

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Vlerësimi i nevojave trajnuese
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme (PTV)

Shtator 2020

Hyrje

Akademia e Drejtësisë edhe gjatë muajit shtator si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 ka vazhduar veprimtarinë e saj të dizajnuar në pajtim me masat dhe kriteret e përcaktuara për mbrojtje dhe parandalim të kësaj pandemie.

Aktivitetet trajnuese kanë qenë të fokusuara vetëm në Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm meqë trajnimet fillestare kanë përfunduar për gjeneratën e VIII të prokurorëve të sapo emëruar dhe aktualisht ky program është në fazën e përgatitjeve për gjeneratën e re të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Përmes këtij buletini informativ në vijim pasqyrohen takimet nga bashkëpunimi ndërinstitutional, me donatorët dhe projektet me qëllim të zhvillimit dhe zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta, aktivitetet në dobi të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimit të programit trajnues për vitin 2021 si dhe aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj.

Përveç aktiviteteve të lartpërmendura, buletini informativ përmban edhe njoftimin dhe zhvillimet sa i përket kurseve trajnuese të realizuara në platformën e mësimin në distancë gjatë muajit shtator.

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe aktivitetet e përbashkëta me donatorët dhe projektet

Në periudhën raportuese, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar bashkëpunimin ndërinstitucional për çështje dhe interesa të përbashkëta dhe ka punuar intenzivisht edhe me përfaqësuesit nga projektet me donatorë me ç’ rast nga takimet e rregullta janë përcaktuar hapat konkret dhe njëkohësisht detajet rreth zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta.

Në vijim janë takimet e realizuara dhe çështjet që janë trajtuar gjatë këtyre takimeve:

Me Ambasadën e SHBA-së, konkretisht me përfaqësuesit e OPDAT janë diskutuar çështjet rreth trajnimit për prokurorët e PSRK-së për konfiskimin e pasurisë, pjesë e të cilit janë menduar edhe zyrtarë nga stafi i AD-se. Në vijim janë diskutuar edhe çështjet tjera sa i përket programit të trajnimit për trajnues që planifikohet të mbahet gjatë muajit nëntor si dhe për punëtorinë e përbashkët me temë “Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme”, ku veçori e kësaj punëtorie ishte metodologjia trajnuese e bazuar në raste duke filluar nga hetuesit policore, prokurorët e më pas tek gjyqtarët.

Në kuadrin e bashkëpunimit me OSBE-në janë zhvilluar takime me qëllim të përgatitjeve për zhvillimin e Trajnimit për Trajnues i cili ka të bëjë me Hartimin e akteve akuzuese.

Me projektin e USAID-it/ CJA (Aktivitete në Drejtësinë Komerciale), janë finalizuar të gjitha dokumentet e nevojshme për shpalljen e kërkesës se interesit për të gjithë profesionistët ligjor në fushën e të drejtës komerciale për të marr pjesë në programin trajnues për trajnues në këtë fushe, është publikuar thirrja për aplikim si dhe është monitoruar procesi i aplikimit.

Në shtator AD dhe Oda e Përmbauesve të Kosovës, ne vazhden e bashkëpunimit të ndërsjellë në avancimin dhe shkëmbimin e përvojave në fushën e trajnimeve, kane nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit. Me këtë marrëveshje synohet që AD të ndihmojë dhe ndajë përvojat dhe njohuritë në fushën e trajnimeve me këtë institucion.

Me kërkesë të emisionit publik “Betimi për Drejtësi”, është realizuar intervista televizive me drejtorin e Akademisë së Drejtësisë në të cilin janë prezantuar të arriturat dhe sfidat e AD-se në zhvillimin dhe zbatimin e programit të trajnimeve për përfituesit sipas ligjit të AD-se.

Në takimet me përfaqësues të Ambasadës Britanike, respektivisht udhëheqësit e projektit “Forcimi i Sistemit të Drejtësisë në Kosovë” është diskutuar bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjelle në zhvillimin e trajnimit për gjyqtarët dhe prokurorët e përzgjedhur, në fushën e ngritjes së shkathësive përmes zbatimit të metodologjisë në raste praktike. Në takim gjithashtu është diskutuar edhe mundësia e bashkëpunimit në zbatimin e masave dhe politikave të rishikimit funksional të sektorit të drejtësisë për AD.

Në takimet me projektin JUFREX të KE-së janë diskutuar çështjet në lidhje me programin e trajnimit për trajner që do të organizohet në muajt në vijim, si dhe është diskutuar pjesëmarrja e trajnerëve të AD në konferencën regionale të radhës që ka të bëjë me lirinë e shprehjes e cila do të mbahet gjatë muajit tetor.

Në vazhden e bashkëpunimit me projektin e KOSEJ 2 të KE-së është integruar në formatin SurveyMonkey (platformë) pyetësi për vlerësimin e nevojave për trajnime për kryetar të gjykatave, gjyqtarë dhe staf administrativ.

Në kuadrin e bashkëpunimit me projektin e BE-së "Projekti për Kodin civil" janë identifikuar temat që do të përfshihen në program sa i përket fushës civile.

Drejtori Ekzekutiv i AD në periudhën raportuese ka prite në takim Drejtorin e Zyrës së KE-së për Kosovë, z. Frank Power, në të cilin janë diskutuar mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në mbështetje të trajnimeve në fushën e të drejtave të njeriut sipas KEDNJ-së.

AD dhe projekti i KE për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në një ceremoni simbolike kanë ndarë certifikatat për vijueshmërinë dhe përfundimin e suksesshëm të kandidatëve që janë trajnuar në modulën e trajnimit për parandalimin e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në kuadër të platformës HELP. Gjithashtu janë takuar dhe kanë diskutuar edhe për programin e trajnimit për trajnues që do të organizohet në muajt në vijim.

Me kërkesë të projektit për Reforma Ligjore të GIZ, zyra në Beograd, AD ka zhvilluar takim virtual me përfaqësuesit e projektit në fjalë. Në takim është biseduar mundësia e bashkëpunimit regjional të Akademive të Drejtësisë në rajon, si dhe prioritet që mund të jene në bashkëpunimin e ardhshëm.

AD ka marr pjesë në Komitetin Drejtues të projektit të BE-së "Projekti për Pronësinë Intelektuale" ku është diskutua raporti progresit dhe asistencë e ardhshme e projektit në fjalë për institucionet e Republikës së Kosovës.

Në vazhden e bashkëpunimit me UNDP është realizuar takimi i radhës ku është diskutuar

zhvillimi kurrikulës trajnuese për mos diskriminimin dhe njëkohësisht është shqyrtuar mundësia e prioritizimit të aktiviteteve nga kjo kurrikulë për vitin 2021.

Me ftesë të Ambasadorës znj. Ariana Zherka – Hoxha, njëherit Drejtoreshë e Departamentit për Organizata Ndërkombëtare në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës së Republikës së Kosovës, Akademia e Drejtësisë përmes përfaqësuesve të saj ka marrë pjesë në takim koordinues ndërinstitucional për përgatitjen paraprake rreth takimit virtual, Kosovë - Këshilli i Evropës, e që pritet të mbahet brenda tetorit. Në takim me KE do të diskutohen mbështetja dhe asistencë e ardhshme e KiE-se, projektet që janë në zbatim e sipër në bashkëpunim me KiE.

AD ka marr pjesë në takim 4-të i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal të Rrjetit të Instituteve të Trajnimit Gjyqësor në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë të Republikës së Serbisë, ku e është diskutuar dhe janë prezantuar praktikat zhvillimit dhe realizimit të trajnimeve online në situatën pandemike.

Gjithashtu gjate këtij muaji AD ka marrë pjesë në Punëtorinë e SEECIP të organizuar nga Akademisë së Drejtësisë të Turqisë, ku janë prezantuar të arriturat dhe sfidat në realizimin e trajnimeve online gjate periudhës së pandemisë.

Në fund AD ka marr pjesë edhe në takim të realizuar me Projektin e BE-se për Mbështetje të Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit për Ndihme Shtetërore. Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi dhe bashkëpunimi në realizimin e disa trajnimeve në fushën e Konkurrencës për zyrtaret e Sistemit të Drejtësisë.

Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të Akademisë së Drejtësisë dhe Odës së Përmbauesve Privat të Kosovës

Më 03 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë dhe Oda e Përmbauesve Privat të Kosovës kanë nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit.



Marrëveshja e Bashkëpunimit, e nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv i AD-së, Enver Fejzullahu dhe Kryetari i OPPK-së, Arben Gashi, ka për qëllim avancimin e bashkëpunimit në mes të institucioneve respektive me qëllim të zhvillimit dhe ngritjes

profesionale të mëtejshëm të shërbimeve të përmbaimit, si dhe zgjerimin e mundësive për projekte të përbashkëta.

Me këtë rast, Kryetari Gashi, u zotua se OPPK do të angazhohet në mënyrë proaktive për vlerësimin e nevojave për trajnim të përmbauesve privat, me qëllim të ofrimit të njohurive dhe përvojave nga fusha e përmbaimit si dhe praktikave më të mira profesionale.

Nga ana tjetër, Drejtori Ekzekutiv i AD-së, është zotuar se institucioni që udhëheq ai do të angazhohet për të bërë zbatimin e trajnimeve për përmbauesit privat, duke synuar arritjen e promovimit të vlerave më të mira profesionale dhe morale të këtij profesioni.



Ceremonia e certifikimit të pjesëmarrësve në kursin HELP

Më 24 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, organizuan ceremoninë e certifikimit të pjesëmarrësve të cilët kanë përfunduar kursin me temë: Dhuna kundër



grave, dhuna në familje përmes platformës së mësimimit në distancë HELP.

Njëkohësisht drejtori ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Enver Fejzullahu u takua edhe me shefin e zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë z. Frank Power me qëllim të vazhdimit të bashkëpunimit në projekte të ndryshme si dhe përshtatjes së aktiviteteve dhe trajnimeve nga kursi HELP në platformën e Akademisë E-learning.

Për shkak të situatës me COVID-19, ceremonia e certifikimit u organizua vetëm me një numër të vogël të pjesëmarrësve nga Gjykata, Prokuroria dhe Shërbimi Policor i Kosovës duke i respektuar masat e parapara..



Takimi i 4-të i Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor të Evropës Juglindore

28-29 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë së Kosovës mori pjesë na takimin e katërt të Rrjetit të Institucioneve të Trajnimit Gjyqësor (SEE JTI). Ky takim dy ditor, i cili u mbajt në formë virtuale, u organizua nga Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC) dhe Akademia Gjyqësore e Serbisë.

Qëllimi i këtij takimi ishte që pjesëmarrësit e rrjetit t'i diskutojnë temat e përbashkëta relevante dhe të pajtohen rreth objektivave të aktiviteteve të rrjetit në periudhën e ardhshme. Fokusi specifik i takimit ishte shkëmbimi i përvojave nga shumë këndvështrime dhe zgjidhje të mësimit në distancë nga secili pjesëmarrës i rrjetit.

Temat rreth të cilave u diskutua dhe u ndanë përvojat nga pjesëmarrësit ishin lidhur me praktikën më të mira të mësimit në distancë dhe mjetet në dispozicion për realizimin e mësimit në distancë nga të gjitha institucionet e trajnimit gjyqësor; promovimi i mësimit të qëndrueshëm në distancë; fuqizimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe shkëmbimit mes këtyre

institucioneve; prezantimi i databazës së ekspertizës ligjore (RLED), që është duke u realizuar nga RCC; si dhe përvojat e të gjitha institucioneve të trajnimit gjyqësor në ofrimin e trajnimeve, qoftë të programit fillestar apo të programit të vazhdueshëm, në formën e mësimit në distancë – sfidat, sidomos në frymën e zhvillimeve si rrjedhojë e situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Ne këtë takim pjesëmarrës ishin përfaqësues nga Këshilli rajonal për bashkëpunim (RCC), Sekretari i përgjithshëm i Rrjetit Evropian të Trajnimit Gjyqësor (EJTN), Këshilli i Evropës zyra në Beograd, Zyra e Bashkimit Evropian në Serbi, përfaqësues nga Arsimimi për Profesionistët Ligjor i Këshillit të Evropës (HELP), GIZ, si dhe përfaqësues nga Akademitë dhe Institucionet e trajnimit gjyqësor të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Punëtori për zhvillimin e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm pas pandemisë COVID-19

Me 30 Shtator 01 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë së Kosovës me ftesë të Ambasadës së Turqisë mori pjesë në punëtorinë për zhvillimin e Programit Fillestarë dhe Programit të Vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë pas pandemisë COVID-19. Ky takim dy ditor, i cili u mbajt në formë virtuale, u organizua nga Ambasada e Turqisë në bashkëpunim me projektin “Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore” (SEECP).

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte bashkëpunimi mes Institucioneve të trajnimit gjyqësor dhe diskutimi i temave të përbashkëta relevante në zhvillimin e mëturjshëm të programeve trajnuese pas situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Gjatë punëtorisë dy ditore, prezantuan një numër i konsiderueshëm i institucioneve për trajnim gjyqësor të cilët shpalosën programet trajnuese si atë fillestarë dhe të vazhdueshëm. Përvojat nga pjesëmarrësit ishin lidhur me praktikën më të mira të mësimin në distancë dhe mjetet në dispozicion për realizimin e mësimin në distancë, sfidat dhe vështirësitë e realizimit të programeve përmes platformës ZOOM dhe ballafaqimin me përdorimin e teknologjisë dhe online-platformave nga pjesëmarrësit në trajnime.

Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë në ditën e dytë të punëtorisë prezantoi Akademinë, aktivitetet e saj si dhe realizimin e programit fillestar dhe të vazhdueshëm gjatë periudhës së krijuar nga pandemia, duke

përfshirë sfidat dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar institucioni në realizimin e objektivave përmes mësimin në distancë dhe përdorimit të platformës ZOOM. Drejtori njëkohësisht shprehi gatishmërinë e Akademisë për bashkëpunim me të gjitha institucionet evropiane për trajnim gjyqësor me qëllim të fuqizimit të mëtejshëm të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira mes këtyre institucioneve.

Ne këtë takim pjesëmarrës ishin Drejtori i Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, Drejtori i Akademisë së Turqisë dhe Zëvendës Ministri i Punëve të Jashtme dhe Drejtor për çështje të BE-së; Profesor nga Shkolla e Magjistraturës së Shqipërisë; Drejtori i Qendrës së Trajnimeve për Gjyqtarë dhe Prokurorë; Udhëheqësi i Sektorit për Trajnim të Vazhdueshëm, Zëvendës Drejtoresha e Institutit Nacional të Drejtësisë, Drejtoresha e Sekretariatit të Qendrës për Trajnim Gjyqësor të Kroacisë, Drejtoresha e Maqedonisë Veriore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, Udhëheqësja e Departamentit për Menaxhim Institucional, Instituti Gjyqësor i Moldavisë; Drejtoresha e Institutit Nacional Gjyqësor të Rumanisë, Drejtori i Akademisë së Drejtësisë së Serbisë; Gjyqtar nga Këshilli Shtetëror si dhe Trajnues në Institutin e Trajnimeve për Gjyqtarë të Greqisë.

Vlerësimi i nevojave trajnuese

Takimet me Gjykatat dhe Prokuroritë (Kryetar të Gjykatave, Udhëheqës të Departamenteve dhe Divizioneve, Kryeprokuror të Prokurorive, prokurorë si dhe trajnues të AD-së)

Në vazhden e identifikimit të nevojave trajnuese për vitin 2021, Akademia e Drejtësisë gjatë muajit shtator ka realizuar takime me Gjykatat dhe Prokuroritë nga gjitha instancat duke përfshirë Kryetar të Gjykatave dhe Kryeprokuror të Prokurorive, kryesuesin e KGJK-së dhe KPK-së, gjyqtarë mbikëqyrës të departamenteve e gjithashtu edhe trajnues të Akademisë së Drejtësisë nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Këto takime u realizuan veçmas për secilën gjykatë dhe prokurori qoftë fizikisht në Akademi të Drejtësisë ose në objektet e Gjykatave dhe Prokurorive si edhe përmes platformës ZOOM duke kontribuar kështu në identifikimin e nevojave për secilën fushë.

Me rastin e këtyre takimeve u diskutuan vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet praktika gjyqësore dhe mundësia e adresimit të tyre përmes Programit Trajnues të Akademisë së Drejtësisë.

Gjatë takimeve, të gjithë njëzëri duke filluar nga Gjykatat dhe Prokuroritë Themelore deri te niveli më i lartë i Gjykatave dhe Prokurorive u konfirmua nevoja për trajnime në fushat

specifike si korrupsioni, krimi i organizuar, keqpërdorimi i detyrës zyrtare, sekuestrimi dhe konfiskimi, prokurimi publik, dhuna në familje dhe çështjet tjera që u bënë të ditura nga mekanizmat tjerë.

Përveç aspektit penal u vunë në pah edhe çështje tjera ligjore nga fusha civile, administrative, ekonomike drejtësia për të mitur si dhe aspekti interdisciplinar.

Më tej, gjyqtarët dhe prokurorët, njëherësh trajnuesit e AD-së nga këto radhë shtruan nevojën e planifikimit të tryezave. Këto tryeza siç u theksua do të mundësonin diskutimin e çështjeve problematike të legjislacionit në fuqi dhe nxjerrjen e ndonjë produkti i cili do të ndikonte në harmonizimin e praktikës.

Akademia e Drejtësisë pas çdo takimi është angazhuar në mbledhjen e rezultateve dhe propozimeve nga këto takime të cilat do ti ketë në konsideratë me rastin e hartimit të Programit Trajnues për vitin 2021.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Aktivitetet e realizuara gjatë muajit shtator në kuadër të Programit të Trajnimeve Fillestare

Përderisa prokurorët e sapo emëruar të gjeneratës së VIII – të-përfunduan Programin e Trajnimit fillestar në muajin paraprak, gjitha aktivitetet në kuadër të këtij Departamenti u fokusuan në finalizimin e raporteve përfundimtare lidhur me vijueshmërinë e programit. Në periudhën raportuese këto raporte u dorëzuan në Këshillin Prokurorial të Kosovës në pajtim me Rregulloren për Trajnimin Fillestar.

Gjithashtu në këtë periudhë është vazhduar me përgatitjet për trajnimin fillestar për gjyqtarët që priten të dekretohen së shpejti. Në këtë drejtim janë duke u hartuar modulet trajnuese sipas përmbajtjes së përcaktuar dhe materialet tjera përcjellëse.

Përveç aktiviteve të lartpërmendura është


filluar edhe me vlerësimin e nevojave trajnuese për gjeneratën e ardhshme të prokurorëve. Lidhur me këtë janë duke u mbledhur propozimet dhe të dhënat nga pyetësorët për vlerësim që u janë dërguar prokurorëve të gjeneratës së VIII-të.

Në funksion të vlerësimit të nevojave trajnuese është realizuar edhe një takim me Komisionin për Vlerësimin e Performancës së prokurorëve, rekomandimet e të cilit Akademia e Drejtësisë i merrë në konsideratë me rastin e hartimit të Programit për prokurorët e gjeneratës së ardhshme.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme dhe rrethanat e tjera që e përjashtojnë kundërligjshmërinë e veprës penale

Më 1 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë: “Mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme dhe rrethanat e tjera që e përjashtojnë kundërligjshmërinë e veprës penale”. Trajnimi u realizua virtualisht përmes platformës elektronike Zoom.




Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë për natyrën, format dhe rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale si dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore lidhur me veprat penale përkatëse.

Gjatë trajnimit u trajtuan format dhe rrethanat që përjashtojnë veprën penale që janë mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme dhe vepra e rëndësisë së vogël, veprat e kryera nën dhunë, kanosje dhe shtrëngim në kushte të caktuara.

Me rastin e këtij trajnimi u theksua se në praktikën gjyqësore nëse një veprë është kryer në këto situata është me rëndësi të vërtetohet fakti që vepra është kryer në rrethanat që e përjashtojnë me të vërtetë përgjegjësinë penale. Në vazhdim vëmendje iu kushtua trajtimit të rasteve praktike të cilat jo rrallë herë paraqesin vështirësi në vërtetimin e këtyre situatave ku pasojat janë shkaktuar mirëpo individin e bëjnë të papërgjegjshëm penalisht.

Në këtë trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika profesionale.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të Apelit dhe nivelit themelor nga të gjitha regjionet si dhe Zyrtar për bashkëpunim profesional dhe mbrojtës të viktimave.



Trajnimi: Pavlefshmëria absolute dhe relative e kontratave si dhe bazat e përgjegjësive për kompensimin e dëmit

Më 02-03 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Pavlefshmëria absolute dhe relative e kontratave si dhe bazat e përgjegjësive për kompensimin e dëmit” në kuadër të PTV-së. Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e mjeteve përmbartimore, pavlefshmërisë së kontratave dhe bazave të përgjegjësive për kompensimin e dëmit.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtuan temat si: Rrethanat që shkaktojnë pavlefshmërinë absolute dhe relative të kontratave; Procedura gjyqësore dhe roli i gjykatës në hetimin e rrethanave që shkaktojnë pavlefshmërinë e kontratave; dhe Efektet që shkaktohen në rastet e shpalljes së pavlefshmërisë së kontratave. Ndërsa në ditën e dytë u trajtuan: Bazat e përgjegjësive për shkaktimin/kompensimin e dëmit; Të provuarit e përgjegjësive dhe roli i gjykatës në procesin e të provuarit të përgjegjësive.

Në trajnim u theksua se kontrata dhe kompensimi i dëmit janë dy prej burimeve kryesore materiale të së drejtës së detyrimeve dhe për rrjedhojë rastet sipas këtyre dy bazave në praktikën gjyqësore janë të shumta. Po ashtu problematikat dhe specifikat më të cilat paraqitën këto raste në praktikë janë të shumta dhe kërkojnë që gjyqtarët të demonstrojnë shkathtësi dhe efikasitet për zhvillimin e procedurës, për identifikimin e çështjeve me rëndësi në kuadër të një kontesti dhe për vlerësimet që duhet të behën përkitazi me

mënyrë e kualifikimit të fakteve në raport me të drejtën materiale.


Në vazhdim u theksua se LMD i ka përcaktuar rrethanat që ndikojnë në pavlefshmërinë absolute dhe relative të kontratave si dhe bazat e përgjegjësive për kompensimin e dëmit, megjithatë në praktikën gjyqësore shpesh paraqitën raste kur gjyqtarët nuk arrin që të japin vlerësime adekuate se cilat rrethana apo cilat baza duhet të vlerësohen në rastin përkatës.

Gjithashtu u potencua se Ligji Për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 2012 është baza ligjore kryesore që rregullon shkaktimin e dëmit dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të. Mosrespektimi i kontratës, shkelja e të drejtave të autorit, shkelja e rregullave të konkurrencës, shkaktimi i dëmit nga mjetet e rrezikshme, dëmi i shkakuar me veprime të kundërligjshme e raste të tjera, janë vetëm disa nga format e shkaktit të dëmit. Kurse, ekzistojnë vetëm dy lloje të shpërblimit të dëmit, shpërblimi i dëmit material dhe shpërblimi i dëmit jo material. Varësisht nga lloji i shkaktit të dëmit sajohet edhe përgjegjësia juridike civile.

Në trajnim u veçua edhe mendimi se praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë temë, mirëpo numri i madh i rasteve nëpër gjykatat e Republikës së Kosovës, dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për kompensim ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete. Në këtë kontekst trajtimi i kësaj teme u mbështet edhe me praktikë të mirëfilltë gjyqësor që do të ndikoj në rritjen e efikasitetit, unifikimit të praktikës gjyqësore dhe rritjes së cilësisë në punën e gjyqtarëve.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor



Trajnimi: Masat edukative dhe dënimet

Më 8 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Masat edukative dhe dënimet”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte diskutimi dhe prezantimi i praktikave më të mira në shqiptimin e masave edukative dhe dënimeve ndaj të miturit me qëllim të zbatimit të drejtë të dispozitave përkatëse që kanë të bëjnë me masat edukative dhe dënimeve ndaj të miturit.


Gjatë këtij trajnimi u trajtua qëllimi i masave edukative dhe përfitimet e aplikimit të tyre, llojet e këtyre duke i shtjelluar në mënyrë të hollësishme secilën nga masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar si dhe masat edukative institucionale. Me tej u diskutua për

kushtet ligjore dhe kriteret që vlerëson gjykata me rastin e shqiptimit të njërës nga masat, përcaktimi i kohëzgjatjes së tyre, si dhe roli i tyre në shmangien nga stigmatizimi i të miturve.

Me rastin e këtij trajnimi vëmendje iu kushtua edhe trajtimit të dënimeve të cilat mund ti shqiptohen një të mituri i cili ka kryer vepër penale e cila është e ndëshkueshme me 5 vite e me shumë burgim.

Metodologjia e zbatuar gjatë trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarët dhe prokurorë e nivelit themelor nga gjitha regionet e Kosovës si dhe nga stafi administrativ prokurorial.



Trajnimi: Arbitrazhi

Më 09-10 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Arbitrazhi” në përkrahje të Programit të USAID’it – Drejtësia Komerciale implementuar nga CHECCHI and COMPANY”.

Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live për dy ditë. Dita I me 09.09.2020 nga ora 10:00-15:30 dhe dita II me 10.09.2020 nga ora 10:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me kompetencat e gjykatës në procedurën e arbitrazhit dhe specifike tjera.

Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Inicimi i procedurës së arbitrazhit dhe kompetencat e gjykatës; Kontestet që mund të jenë objekt i arbitrazhit; Klauzola e

marrëveshjes së arbitrazhit, Procedura e arbitrazhit, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurë; Ligji Kosovar për njohjen e vendimeve të arbitrazhit.

Në trajnim u vazhdua me Inicimin e procedurës së njohjes; Praktikat e njohjes së vendimeve të arbitrazhit; Procedurat e parapara në Konventën e New York për zbatimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit; Njohja dhe zbatimi i vendimeve të huaja të arbitrazhit në Kosovë si dhe Mjetet juridike të aplikueshme.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatave Themelore si dhe Bashkëpunëtorë profesional.



Trajnimi: Etika Profesionale Prokurorët - Gr.I

Më 14 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin, me temë “Etika Profesionale ”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të prokurorëve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën vlerat e respektimit të standardeve etike.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom në fokus ishte elaborimi i normave të zbatueshme etike dhe normave tjera të mirësjelljes, rëndësisë së profesionalizmit, integritetit dhe dinjitetit moral, parimit të pavarësisë dhe paanësisë si dhe faktorëve që ndikojnë në cenimin e këtyre parimeve. Me rastin e këtij trajnimi u potencua që këto parime ndikojnë në ngritjen e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe kanë ndikim në forcimin e besimit të publikut ndaj sistemit në tërësi. Më tej u theksua se prokurorët duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, të

shmangin çdo konflikt interesash të shmangin gjithnjë komunikimin ex parte me palë. Këta duhet të veprojnë në atë mënyrë që të kontribuojnë dhe të ngritin besimin te publiku për sistemin prokuroral. Vazhdimisht të kërkojnë respektimin e rreptë të rendit dhe sjelljes së përshtatshme gjatë ushtrimit të funksionit të tyre dhe të ruajnë dhe të përqipen vazhdimisht të përmirësojnë standardet më të larta profesionale dhe të ekspertizës ligjore.

Vëmendje iu kushtua procedurës disiplinore ndaj prokurorëve ku përfshihen ndryshimet ligjore, veprimet e prokurorit që përfshihen në shkelje disiplinore, masat disiplinore, ankesat dhe përmbajtja e saj si dhe veprimet e Autoritetit kompetent.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Kryeprokurori nga Apeli, Kryeprokuroret e Prokurorive Themelore si dhe prokurorë nga regjionet ndryshme të Kosovës.



Trajnimi: Personat Juridik ne procedurën e kundërvajtjes

Më 15 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme (PTV), realizoi trajnimin me temë “Personat Juridik në procedurën e kundërvajtjes”.

Trajnimi u realizua virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live nga ora 10:00-15:30.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në zbatimin e drejtë të procedurës kundërvajtëse ndaj personave juridik dhe në përkufizimin e drejtë të subjekteve afariste - persona juridik si dhe në përgjegjësinë e personit të pandehur juridik.

Në fokus të trajnimit ishin: Mënyrat e zhvillimit të procedurës për kundërvajtje ndaj subjektit afarist që ka cilësinë e personit juridik dhe ndaj personit përgjegjës juridik.

Gjatë trajnimit janë elaboruar: Përgjegjësia e personit juridik dhe përgjegjësia e personit përgjegjës të personit juridik, subjektet afariste si biznese individuale dhe zhvillimi i procedurës ligjore ndaj tyre si dhe përgjegjësia e personave si Përgjegjësia e personit juridik si dhe përgjegjësia e personit përgjegjës.

Metodat e aplikuara në trajnim ishin metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtar nga Nivelit Themelor-Divizioni penal dhe divizioni për kundërvajtje si dhe bashkëpunëtor profesional.



Trajnimi: Fillimi dhe zhvillimi i konflikteve administrativ

Më 17 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ-LARP Projekti për Reforma Ligjore dhe Administrative, realizoi trajnimin me temë: “Fillimi dhe zhvillimi i konflikteve administrative” në kuadër të PTV-së.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprime të organeve të administratës publike.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan temat në vijim: Rëndësia e dispozitave ligjore për procedurën e konflikteve administrative; Procedura ligjore, roli dhe rëndësia e nxjerrjes së provave gjatë shqyrtimit kryesor; Nxjerrja e aktgjyqimit në konfliktin administrativ dhe mjetet juridike. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtua: Përmbartimi i vendimeve me veçoritë që e përcjellin këtë fazë.

Në kuadër të këtij trajnimi fokusi ishte në mbrojtjen gjyqësore dhe adresimin e ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit.

Gjithashtu u theksua se Gjykata vendosë në seancën e shqyrtimit kryesor në çështjen e

konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurës administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do ta anulon me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë në rishqyrtim organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerr akt të ri administrativ.

Në vazhdim u theksua se në qoftë se organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, paditësi mund të parashtrij padi të re dhe gjykata mund të anuloj aktin e kontestuar me aktgjykim i cili krejtësisht e zëvendëson aktin administrativ të anuluar.

Në këtë trajnim pas një debati përmbajtësor dhe shpjegimeve të trajnuesve u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve në këto departamente dhe në instancë të fundit do të ndikonin në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve në gjykata.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit të Kosovës, gjyqtarët e gjykatave themelore (Departamentit për Çështje Administrative) të të gjitha regjioneve si dhe zyrtarë për bashkëpunim profesional.

Trajnimi: Etika Profesionale Prokurorët - Gr.II

Më 21 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin virtual përmes platformës Zoom me temë “Etika Profesionale”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën vlerat e respektimit të standardeve etike.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan normat e zbatueshme etike dhe normat tjera të mirësjelljes, rëndësisë së profesionalizmit, integritetit dhe dinjitetit moral, parimit të pavarësisë dhe paanësisë si dhe faktorëve që ndikojnë në cenimin e këtyre normave. Me rastin e këtij trajnimi u theksua se shtrirja e këtyre normave ka ndikim në ngritjen e standardeve më të larta të sjelljes etike dhe njëkohësisht në forcimin e besimit të publikut ndaj sistemit në tersi. Në vazhdim u tha se prokurorët duhet të veprojnë në mënyrë të

pavarur dhe të paanshme, të shmangin çdo konflikt interesash dhe të shmangin gjithnjë komunikimin ex parte me palë. Gjithashtu duhet të veprojnë në atë mënyrë që të kontribuojnë dhe të ngritin besimin te publiku për sistemin prokuroral. Vazhdimisht të kërkojnë respektimin e rreptë të rendit dhe sjelljes së përshtatshme gjatë ushtrimit të funksionit të tyre dhe të ruajnë dhe të përpiqen vazhdimisht të përmirësojnë standardet më të larta profesionale dhe të ekspertizës ligjore.

Vëmendje iu kushtua procedurës disiplinore ndaj prokurorëve ku përfshihen ndryshimet ligjore, veprimet e prokurorit që përfshihen në shkelje disiplinore, masat disiplinore, ankesat dhe përmbajtja e saj si dhe veprimet e Autoritetit kompetent.

Përfitues të këtij trajnimi ishin kryeprokurorët e prokurorive themelore, prokurorë nga regjionet e Kosovës.



Program i Specializuar Trajnimi- Prokurimi Publik i Kosovës- Sesioni II

Më 22-23 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin përmes platformës Zoom me temë “Program i Specializuar Trajnimi- Prokurimi Publik i Kosovës- Sesioni II”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi njohurive të pjesëmarrësve rreth implementimit të kontratës, hetimit dhe gjyqimit të veprave penale të kësaj natyre.


Gjatë këtij trajnimi u trajtuan: faza e implementimit të kontratës, vlerësimi i nevojave/përcaktimi i kërkesave, përgatitja/procesi i dizajnit dhe përgatitja e dokumenteve të ofertimit, zgjedhja e kontraktorit dhe faza e dhënies së çmimit.

Me theks të veçantë u theksuan skemat korruptive dhe problemet e ndërlidhura me mashtrim, si të bëhet planifikimi i hetimit dhe ndjekja. Po ashtu u trajtuan edhe pagesa e

haraçit, konflikti i interesit, skemat e kurdishjes së ofertave, ofertimi konspirativ, skemat mashtruese, përmbajtja e planit të hetimit, identifikimi i burimeve të informacionit, planifikimi i kontrollit të shtëpisë dhe përgjimi, planifikimi i përdorimit të informatorëve si dhe planifikimi i gjurmimit të aseteve.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.

Përfitues të këtij sesioni trajnues ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore nga regionet e ndryshme të Kosovës.



Punëtori: Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme

Më 22-23 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, ka realizuar punëtorinë virtuale përmes platformës ZOOM me temë “Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme”.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe elaborimit të këtyre rasteve të ngritën kapacitetet profesionale të hetuesve policor, të prokurorëve dhe gjyqtarëve në konfiskimin e pasurisë së paligjshme.

Me rastin e kësaj punëtorie u trajtuan aspektet procedurale me fokus te identifikimi i asetëve dhe të provuarit për qëllime konfiskimi. Të gjitha këto çështje u trajtuan përmes rasteve praktike dhe punës në grupe me ç ‘rast prokurorët pjesëmarrës të ndihmuar nga hetuesit policor po ashtu pjesëmarrës në këtë trajnim identifikuan asetet me potencial për

konfiskim. Më tej gjatë punëtorisë pjesëmarrësit kishin për detyrë që për secilin aset të jepet një prezantim mbi të gjeturat.

Gjatë kësaj punëtorie u diskutua edhe vlerësimi i provave në rastet e konfiskimit duke u fokusuar në atë se çfarë i duhet Gjykatës për të marrë vendim përfundimtar rreth konfiskimit. Në vazhdim prokurorët pjesëmarrës kishin për detyrë që të prezantojnë një aset të identifikuar dhe provat që e mbështesin kërkesën e tyre për konfiskim.


Në fund edhe nga këndvështrimi i gjykatës u trajtua procedura e marrjes së vendimit sipas kërkesës së prokurorit për konfiskim.

Pjesëmarrës në këtë punëtori ishin gjyqtarët, prokurorët e emëruar koordinator për konfiskim, prokurorët e Prokurorisë Themelore si dhe hetuesit policor.



Trajnimi: Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre

Më 29 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, përmes platformës Zoom ka realizuar trajnimin me temë “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe efektet juridike të tyre”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, natyrën juridike, efektin si dhe mënyrën e përmbartimit të tyre.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan temat: roli i Vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, rëndësia si dhe efektet juridike të tyre., Llojet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe mënyrat e përmbartimit si dhe zbatimi i drejtë i tyre.

Në vazhdim u potencua se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, ajo mund të suspendojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i veprimit a ligjit të kontestuar, mund të shkaktoj dëme të pariparueshme.

Më tej u veçua qëndrimi se siç përcaktohet edhe me Kushtetutë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese vepron vetëm në një instancë dhe ndaj vendimeve të saja nuk mund të apelohej asnjë ankesë ose mjet tjetër juridik i rregullt ose i jashtëzakonshëm.

U potencua se individët mund të parashtrojnë kërkesa në Gjykatën Kushtetuese, vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit. Gjykata Kushtetuese në shumë vendime të saj e racionalizon këtë parim kushtetues me argumentin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut që së pari duhet mundësuar që institucionet e rregullta të shtetit e veçanërisht gjykatat të korrigjojnë shkeljen, para se rasti të arrijë në Gjykatën Kushtetuese.

Duke analizuar dispozitat e “Nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës u potencua se ky nen obligon gjyqtarët që në vendimet e tyre gjyqësore të reflektojnë frymën interpretative të GJEDNJ në Strasburg. Ndonëse kjo praktikë e referimit në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nga gjykatat e rregullta është akoma në fazën fillestare, Gjykata Kushtetuese e Kosovës në mënyrë të qëndrueshme i është referuar kësaj praktike gjyqësore kur është ballafaquar me çështje-shqyrtimi i të cilave ka qenë kufizimi i lirive dhe të drejtave kushtetuese.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga trajnuesit, përmes analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me përqendrim në efektin dhe zbatimin adekuat të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në praktikën gjyqësore të Republikës së Kosovës, në rajon dhe më gjerë.

Përfitues ishin gjyqtarët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

Trajnim: Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme


Më 30 shtator-1 tetor 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Drejtësisë/OPDAT, ka realizuar trajnimin me temë “Avansimi i konfiskimit të pasurisë së paligjshme”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zhvillimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të rasteve nga praktika të ngritën kapacitetet profesionale të hetuesve policor, të prokuroreve dhe gjyqtareve.

Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtua konfiskimi i drejtuar ndaj pasurisë së personit që ka kryer veprë penale që

rezultat i saj ka përfitimin e kundërligjshëm. Në vijim u potencua që institucionet e zbatimit të ligjit duhet të hetojnë çdo pasuri e cila është përfituar me veprë penale. Me rastin e këtij trajnimi vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe arsyetimit të mirë të kërkesave të prokurorëve të bazuara në prova për ngrirje, ndalim dhe konfiskim të pasurisë së paligjshme. Lidhur me këtë u tha që kërkesat e prokurorëve nuk janë të arsyetuara mirë dhe si pasojë e kësaj ka raste që dështojnë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët, prokurorët e emëruar koordinator për konfiskim, prokurorët të prokurorisë themelore si dhe hetuesit policor.



Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Trajnimi: Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial

Më 30 Shtator 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Menaxhimi i punës në administratën e sistemit gjyqësor dhe prokurorial”. Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom direkt/live nga ora 10:00- 15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive në zbatimin e standardeve adekuate të menaxhimit dhe udhëheqjes përmes hartimit të planeve, marrjes së vendimeve të arsyeshme dhe krijimit të ambientit për punë kreative dhe të suksesshme.


Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan menaxhimi i punës dhe udhëheqja në periudhë krizash globale si dhe nivelet e hierarkisë dhe ushtrimi i menaxhimit aktiv në kohë krizash.

Vëmendje e veçantë iu kushtua Planit për menaxhimin e krizës së pandemisë, struktura dhe efekti i funksionimit të tij në praktikë,

rreziqet e paprecedent siç është pandemia Covid -19 si të menaxhohen, lehtësohen, eliminohen apo të parashikohen.


Gjithashtu gjatë trajnimit u diskutua për parimet e menaxhimit, roli dhe rëndësia e menaxherit, shkathtësitë dhe kompetencat menaxheriale, si të bëhet dallimi i menaxherit nga udhëheqësi dhe si të ushtrohet funksioni i manaxherit bazuar në standarde që garantojnë sukses. Metodologjia e aplikuar ishte e kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive ,ku trajnuesit ndanin eksperiencat e tyre duke transmetuar njohurit e tyre profesionale për punë sa më efikase.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Administratorët dhe ndihmës administratorët e gjykatave dhe Administratorët e prokurorive nga të gjitha regjionet e Republikës së Kosovës.



Trajnimi i Trajnuesve (ToT) “Hartimi i Avancuar i Aktakuzave”

Më 31 gusht deri më 04 shtator 2020, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me OSCE ka realizuar trajnimin pesë (5) ditor për Trajnues (ToT) rreth “Hartimit të Avancuar të Aktakuzave”.




Qëllimi i këtij trajnimi ishte hartimi i akteve akuzuese në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore në mënyrë që ato të jenë sa më profesionale dhe efektive.



Në kuadër të këtij trajnimi u diskutuan çështje rreth Kallëzimit penal, Rëndësisë së Akteve Akuzuese, përfaqësimit të Aktakuzës, Llojeve të Aktakuzës, Ndryshimit dhe zgjerimit të aktakuzës, Hartimit të akteve akuzuese dhe identifikuan mangësitë eventuale që më së shumti ndodhin në praktikën gjyqësore.

Përveç trajnuesve vendor, trajnimi është mbështetur edhe nga trajnues/ekspert ndërkombëtar me qëllim të unifikimit të përvojave dhe praktikave ligjore.


Përfitues të trajnimit janë Prokurorë të niveleve të ndryshme brenda territorit të Republikës së Kosovës.



Vijueshmëria në trajnime në PTV e prezantuar përmes grafikoneve




Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Institutioneve Shtator 2020




Pjesëmarrja sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike Shtator 2020





Nr. i trajnimeve dhe i pjesëmarrjes në TiT Shtator 2020



Kurset e mësimit në distancë-Elearning

Gjatë muajit shtator platforma e mësimit në distancë ka vazhduar të jetë e hapur për pjesëmarrësit e interesuar (Gjyqtarë, Prokurorë, staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive si dhe për studentët e Fakulteteve Juridike) pa afat të caktuar kohor.

Në kuadrin e kësaj platforme janë 18 kurse të çashtme online, 8 prej të cilave edhe në gjuhën serbe.

Më 20 korrik 2020, sipas Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (Nr. 06/2019) për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores (Nr. 06/2017) është lëshuar online edhe kursi obligativ “Etika profesionale” për gjyqtarët e Republikës së Kosovës.

Për në detaje janë tabelat të cilat prezantojnë vijueshmërinë dhe progresin në ndjekjen e kurseve sipas temës në këtë platformë.

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Shqip)</i>	202	73%	44	16%	29	11%
<i>Etika Profesionale I</i>	213	77%	47	11%	15	5%
<i>Etika Profesionale II</i>	227	83%	20	7%	28	10%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>(Etika Profesionale) Procedura dhe përgjegjësia disiplinore (Serbisht)</i>	26	9%	18	7%	23	84%
<i>Etika Profesionale I (Serbisht)</i>	24	9%	79	29%	172	63%
<i>Etika Profesionale II (Serbisht)</i>	24	9%	49	18%	202	73%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Masat e Diversitetit</i>	3	3%	9	8%	101	89%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi Efektiv</i>	3	18%	12	71%	2	12%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtësia për fëmijë aspekti Civil</i>	16	16%	19	17%	76	67%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Drejtësia për fëmijë aspekti Penal</i>	10	19%	15	13%	88	78%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Hetimi dhe zbulimi i Korrupsionit</i>	11	10%	10	9%	92	81%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Korrupsioni sipas legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar</i>	7	6%	7	6%	99	88%
Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i Gjykatës</i>	13	12%	6	5%	94	83%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Udhëheqësia - Lidershipi</i>	11	10%	9	8%	93	82%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Shqip)</i>	9	8%	19	17%	85	75%
<i>E drejta e autorit dhe mbrojtja juridike (Serbisht)</i>	2	22%	3	33%	4	44%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Shqip)</i>	19	17%	16	14%	78	69%
<i>Faza e aktakuzës dhe deklarimit për Fajësinë (Serbisht)</i>	2	22%	3	33%	4	44%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Menaxhimi i stresit (Shqip)</i>	38	34%	20	18%	55	49%
<i>Menaxhimi i stresit (Serbisht)</i>	6	67%	3	33%	0	0%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Shqip)</i>	9	8%	8	7%	96	85%
<i>Shkathësitë e komunikimit social (Serbisht)</i>	2	22%	3	33%	4	44%


Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Shqip)</i>	7	7%	6	6%	87	87%
<i>Trajnimi për implementimin e legjislacionit tati-mor në Kosovë (Serbisht)</i>	1	11%	3	33%	56	56%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Shqip)</i>	15	13%	40	35%	58	51%
<i>Komunikimi dhe marrëdhëniet me publikun (Serbisht)</i>	1	11%	4	44%	4	44%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Anglishtja Ligjore</i>	39	35%	23	20%	51	45%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Teknologjia Informative</i>	32	28%	14	12%	67	59%

Emri i Kursit	Kompletimi i Kursit	Përqindja	Në Progres	Përqindja	Nuk kanë filluar fare	Përqindja
<i>Dhuna në Familje (Shqip)</i>	0	0%	19	86%	3	14%
<i>Dhuna në Familje (Serbisht)</i>	0	0%	3	23%	10	77%



Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>